



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1671 / Prot.

Tiranë, më 29.06 2023

V E N D I M

Nr. 42 datë 29.06.2023

**"PER  
MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS, REGJISTRIMIT  
TË FITUESVE, PËR CIKLIN E PARË DHE TË DYTË, TË TRETË TË STUDIMEVE  
DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR TË TRE CIKLET E STUDIMEVE, NË  
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"**

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH pika 3/ç të nenit 3, nenit 6, pika 28,29,30 neni 49, neni 83, neni 85, në Statutin e UST, në Rregulloren e UST, në VKM nr. 288 datë 21.05.2018" Per miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në IPAL, në një program të ciklit të parë të studimeve ose në një program të integruar të studimeve profesionale me kohë të plote", në Urdhërin e MASR me Nr.495, datë 11.10.2019 "Për hapjen e njësisë kryesore "Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit" në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Urdhërin nr. 245 datë 22.07.2020 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Shkenca te Rehabilitimit" në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në VKM nr. 778, dt. 26.12.2018; në VKM nr. 779 dt. 26.12.2018 " Për disa ndryshime në VKM nr. 269, dt.29.03.2017" "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar", në VKM nr. 780 dt. 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimeve, në IAL Publike", në Udhëzimin nr. 10, date 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e Arsimit të Lartë ", në Urdhërin e Ministres nr. 355 datë 17.09.2021 "Për hapjen e Programit të studimit të ciklit të dytë "Master profesional në Trajner i Përgatitjes Fizike, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në Vendimin e Senatit nr. 46 date 07. 04.2023 "Mbi miratimin e kuotave të pranimit, për vitin akademik 2023-2024", në Vendimin e Rektoratit nr. 61 datë 22.06.2023, në Vendimin e Senatit Akademik nr.75 datë 26.06.2023 Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 29 .06.2023,

## VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit në konkursin praktik të aplikantëve (FSHL, FVFR) dhe tarifat e regjistrimit të fituesve (FSHL, FVFR, FSHR) për ciklin e parë të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelave bashkëngjitur.
2. Tarifat e regjistrimit në konkurimin praktik të aplikantëve, tarifat e aplikimit dhe tarifa e regjistrimit të fituesve të kandidatëve nga trojet, kandidatëve me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, kandidatëve të komunitetit rom dhe egjyptian në programet e ciklit të parë, transferim studimesh dhe program të dytë studimit, për vitin akademik 2023-2024, janë të njëjta me tarifat, për ciklin e parë të studimeve.
3. Tarifat e aplikimit të kandidatëve, kandidatëve për transferim studimesh e të tjerë dhe tarifa e regjistrimit të fituesve për ciklin e dytë të studimit (program i parë/ program i dytë), për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelave bashkëngjitur.
4. Të miratojë tarifën e shkollimit për ciklin e parë të studimeve bachelor, për të gjithë programet e studimit, për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelave bashkëngjitur.
5. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti, i cilësuar në bazë të rregullores së Institucionit të Arsimit të Lartë Publik si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
6. Studenti që i mbetet vetëm provimi i formimit dhe nuk është i detyruar të ndjekë studimet gjatë vitit akademik 2023-2024, duhet të paguajë vetëm tarifën për kreditet e mbetura.
7. Studentët të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti 2023-2024 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit, sipas tabelës bashkëngjitur, ndërsa studentët me mesatare mbi 6 paguajnë 50% të tarifës vjetore të shkollimit, pjesa tjetër rimburohet nga fonde grand të buxhetit të shtetit.
8. Studentët që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve dhe rezultojnë me mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitet e mëparshme të programit të studimit përkatës, brenda përfundimit të vitit akademik paraardhës përjashtohen nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2023-2024.
9. Studentët e pranuar në vitin e parë akademik me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) - 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlllogaritur si mesatare të notave të të gjithë viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë dhe provimet e maturës shtetërore sipas listës së sjellë nga QSHA, përjashtohen nga tarifa e shkollimit, për vitin akademik 2023-2024.
10. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin transferohen dhe ndjekin studimet.
11. Kandidatët/aplikantët, që kanë përfunduar me sukses një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, sipas kritereve të përcaktuara nga vetë institucionet publike

të arsimit të lartë për pranimet në një program të dytë studimi dhe, në këtë rast, aplikantët fitues përballojnë koston e plotë të studimeve, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

12. Shtetasit e huaj, që vazhdojnë studimet në një program të parë apo në një program të dytë studimi të ciklit të parë në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë vjetore të shkollimit, si shtetasit shqiptarë që vazhdojnë studimet në këto programe studimi, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave vjetore të shkollimit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dërgon për çdo vit listën e studentëve të huaj që përfitojnë nga marrëveshjet zyrtare shtetërore.

13. Të miratojë tarifën e shkollimit për studentët që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve, për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelave bashkëgjitur dhe e paguajnë tarifën e shkollimit të ndarë në këste.

14. Studentët të cilët nuk kanë përfunduar programin përkatës të studimit të ciklit të dytë apo nuk kanë shlyer të gjithë provimet e parashikuara në atë program studimi, në kohëzgjatjen normale të tij dhe konsiderohen mbetës/përsëritës për lëndët përsëritëse, do të paguajnë tarifën për kredit të parashikuar sipas këtij vendimi.

15. Studentët e ciklit të dytë sipas shtresave në nevojë, studentët që vijnë nga cikli i parë i studimeve me notën mesatare 9-10 dhe studentët që vazhdojnë studimet në ciklin e dytë në vitin pas të parit dhe kanë shlyer të gjithë detyrimet akademike për vitin akademik. paraardhës me mesatare të vitit paraardhës 9-10, përjashtohen 50% nga tarifa e shkollimit.

16. Studentët e ciklit të parë dhe të dytë që plotësojnë kriteret për tu përjashtuar nga tarifa e shkollimit plotësisht apo 50% të saj duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës brenda afateve të përcaktuara që do të nxirret në [eee.ust.edu.al](http://eee.ust.edu.al) dhe lista përfundimtare e tyre miratohet nga Bordi i Administrimit.

17. Të miratojë tarifën e regjistrimit të aplikantëve (FShL, FVFR) dhe tarifën e regjistrimit të fituesve (FShL, FVFR) për ciklin e tretë të studimit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024, sipas tabelave bashkëgjitur.

18. Tarifën e regjistrimit në konkursin praktik, aplikimit për ciklin e dytë dhe të tretë dhe të regjistrimit të fituesve të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al), pas miratimit nga Bordi i Administrimit.

19. Tarifën vjetore të shkollimit për të tre ciklet e studimit do të bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

20. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek portali i transparencës universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**



Rr. Muhamet Gjollësia, Tiranë, Tel: 35542226652, [eee.ust.edu.al](http://eee.ust.edu.al), [contact@ust.edu.al](mailto:contact@ust.edu.al)

**Tab. 1****FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES**

Tarifa e regjistrimit në konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve Program i dytë i studimeve)	5 000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, Program i parë i studimeve / Program i dytë i studimeve)	2.000 lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve)	2500 lekë
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3 000lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i parë i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2.000 leke
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të tretë të studimeve) 5000 lekë	
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në programet e ciklit të tretë të studimeve) 2.000 leke	

**Tab. 2**

**FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT**

Tarifa e regjistrimit ne konkurset e pranimit praktik (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ Program i dytë i studimeve)	5000 leke
Tarifa e regjistrimit të fituesve në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ Program i dytë i studimeve)	2000 leke

Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve)	2 500leke
Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve dhe transferimet e studimeve dhe të tjerë)	3000leke
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Programet e Ciklit të dytë të studimeve program i pare i studimeve/ program i dytë i studimeve)	2 000lekë

Tarifa e aplikimit të kandidatëve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	5 000 lekë
Tarifa e regjistrimit të fituesve (në programet e ciklit të tretë të studimeve)	2 000 lekë

**Tab. 3**

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT**

Tarifa e regjistrimit të fituesve (në Ciklin e parë të studimeve, program i parë i studimeve/ Program i dytë i studimeve)	2.000 lekë
---	------------

Tab 4

Fakulteti i Shkencave të  
Lëvizjes

Emërtimi i Programit cikli i parë	Tarifa për program të parë studimi (në lekë) për vitin akademik 2023-2024	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2023-2024
Bachelor		
	35000	233916
Shkencat e Lëvizjes		

Emertimi I Programit cikli I dyte Master Profesional	Tarifa per kredit per program te pare studimi ( ne leke)/ 60 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024	Tarifa per kredit per program te dyte studimi ( ne leke) per vitin akademik ne leke / 60 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024
Trajner i pergatitjes fizike	1083 (65000)	1250 (75000)

Emertimi I Prograit cikli I dyte Master Shkencor	Tarifa per kredit per program te pare studimi ( ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024	Tarifa per kredit per program te dyte studimi ( ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024
Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetsor (FSHL)	1750 (210000)	2125 (255000)

Emertimi i Prograit cikli i dyte Master Shkencor	Tarifa per kredit per program te pare studimi ( ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024	Tarifa per kredit per program te dyte studimi ( ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024
Shkenca Sportive (FSHL)	1750 (210000)	2125 (255000)

Shenim: Për arsye të aplikimit për riorganizimin e programit të studimit nga MP në fushën Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar në MSH në Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor tarifa e shkollimit do të miratohet pas përgjigjes nga MASR për këtë program studimi.

**Tab 5**

**Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit**

Emërtimi i Programit cikli i parë	Tarifa për program të parë studimi (në lekë) për vitin akademik 2023-2024	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2023-2024
Bachelor		
	35000	233916
Fushat e veprimtarisë fizike të shëndetit dhe të rekreacionit		

Emertimi I Programit cikli I dyte Master Profesional	Tarifa per kredit per program te pare studimi ( ne leke)/ 60 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024	Tarifa per kredit per program te dyte studimi ( ne leke) per vitin akademik ne leke / 60 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024
Menaxhim në Sport dhe Turizëm	1250 (75 000)	1520 (91 200)
Aktivitet Fizik dhe Rekreacion- Trainer fitness (FVFR)	1330 (79 800)	1530 (91 800)

Emertimi I Prograit cikli I dyte Master Shkencor	Tarifa per kredit per program te pare studimi ( ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024	Tarifa per kredit per program te dyte studimi ( ne leke)/ 120 kredite ne leke per vitin akademik 2023-2024
Aktivitet Fizik dhe Shëndeti (FVFR)	1750 (210000)	2125 (255000)

**Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit****Tab 6**

Emërtimi i Programit cikli i pare Bachelor	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2023-2024	Tarifa për program të dytë studimi (në lekë) për vitin akademik 2023-2024
Fusha Shkenca të Rehabilitimit	35 000	233 916

Shenim: Për arsye të aplikimit të FSHR për hapjen e programit të studimit MP në fushën “Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport” tarifa e shkollimit do të miratohët pas përgjigjes nga MASR për këtë program studimi dhe nëse miratohet tarifa do të jetë si tabela më poshtë vijon.

Emërtimi i Programit Master Profesional	Tarifa për program të parë studimi (në lekë)për vitin akademik 2023-2024
Rehabilitim Fizioterapeutik në Sport	72.000